



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 124 / Prot.

Vlorë më, 14.06. 2025

VENDIM

Nr. 50, datë 27.06.2025

**PËR MIRATIMIN E KATEGORISË SË PAGAVE PËR DREJTORËT E
DREJTORIVE TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, pika nj, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, ", VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr.16, datë 16.06.2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për zbatimin e VKM nr.325, datë 31.05.2023", referuar propozimit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore me shkresë 1252/1 prot, datë 26.06.2023 si dhe shkresës së Administratorit të UV-së 1582/1, prot, datë 27.06.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 27.06.2025,

VENDOSI:

1. Të miratojë kategorinë e pagës për pozicionet si më poshtë vijojnë:
 - a) Drejtorët e drejtorive në UV do të paguhet sipas kategorisë III-I
 - b) Përgjegjësi i Sektorit Ekonomik do të paguhet sipas kategorisë III-II
 - c) Përgjegjësi i Sektorit të Prokurimeve do të paguhet sipas kategorisë III-II.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Sektori Ekonomik, dhe Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-Arkivës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKODLA